

POGRADEC, me 12 Dhjetor 2013

NrProt.

VENDIM Nr. 3
date 12.12.2013

IASAMBLESE SE PERGIJTHESHME TE SHOQERISE
BENAKS 94 SHPK

Sot ne Pogradec, ditën e enjte me date dymbëdhjet te muajit Dhjetor te vitit dymije e trembëdhjete m ne Seline e shoqerise "BENAKS 94" sh.p.k. ne aendren e shoqerise ne Ruga nacionale Pogradec - Korce km 1 u mblodh Asamblea e Pergjitheshme e Shoqerise dhe vendosi sa vijon:

1 -Te realizohet zmadhimi i kapitalit te shoqerise, me perfshirjen te fitimeve te pashperndara nder vite dhe fitimet e vitit financiar te miratuara ne Pasqyrat Financiare (bilancin) e vitit 2012.

2 -Te emeroje Ekspert te fushes, Kontablin e miratuar per zmadhimin e Kapitalit te Shoqerise " BENAKS 94 " sh.p.k, Z. Bashkim KILLO, I biri I Qaniut, I datelindjes 10.04.1948 m lindur ne Pogradec dhe banues ne lagjen Nr.2, Ruga " Rinia " I pajisur me licensen Profesionale Nr. 401 date 17.07.1998 " Kontabel I Miratuar".

3 -Te miratoje Raportin e Kontablit te Miratuar ne lidhje me Zmadhimin e Kapitalit nga Fitimet e mbartura te pa shperndara si dhe

fitimet e vitit ushtrimor sipas bilancit te date 31.12.2013 . Kapitali i nenshkruar nga 100,000 leke te jete **43,432,112.00 leke (dyzet e tre milion e katerqind e tridhjet e dy nije njeqind e dymbëdhjete leke)** (shtesa e kapitalit eshte 43,332,112.00 leke) Numuri I Pjeseve (Kuotat) nga 100 me vlera nominale 1000 leke te behet 43,432.11 pjese.

4 -Te depozitohet ky Vendim ne QENDREN KOMBETARE TE RREGJISTRIMIT .

Sa me siper nenshkruhet pa verejtje,

ORTAKU I VETEM

(BESNIK IBI)



SHOQERIA TREGETARE "BENAKS 94" SH P K
NIPT J 73804663 H
POGRADEC
KORÇE

POGRADEC , me 25 Maj 2015

VENDIM Nr.3

date 25.05.2015

LASAMBLESE SE PERGJITHESHME TE SHOQERISE
"BENAKS 94" SHPK

Sot ne Pogradec, ditën e enjte me date njezet e pese te muajit Maj te vitit dymije e pesëmbëdhjet, ne Seline e shoqerise " BENAKS 94" sh.p.k. ne qendren e shoqerise ,Rruga nacionale Pogradec- Korce km 1,krahu i djathte,prane kryqezimit Bucimas, u mblodh Asambleja e Pergjitheshme e Shoqerise dhe vendosi sa vijon :

- 1 -Te realizohet zmadhimi i kapitalit te shoqerise , me perfshirjen te fitimeve te pashperndara nder vite dhe fitimet e vitit financiar te miratuara ne Pasqyrat Financiare (bilancin) e vitit 2014 .
- 2 - Te emeroje Ekspert te fushes, Kontablin e Miratuar per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise " BENAKS 94 " sh.p.k , Z. Bashkim KILLO , biri i Qaniut , i datelindjes 10.04.1948 , lindur ne Pogradec dhe banues ne lagjen Nr.2 , Rruga « Rinia « i pajisur me *licensen Profesionale Nr. 401 date 17.07.1998 « Kontabel i Miratuar »* .
- 3 - Te miratoje Raportin e Kontablit te Miratuar ne lidhje me Zmadhimin e Kapitalit nga Fitimet e mbartura te pa shperndara si dhe fitimet e vitit ushtrimor sipas bilancit te date 31.12.2014 . Kapitali i



neneshkruar nga 43,432,112.00 leke te *jete* 58,087,300.00 leke (*dyzet e tre milion e katerqind e tridhjet e dy mije njeqind e dymbeshjete leke*) (shtesa e kapitalit eshte 14,655,188.00 leke)
Numuri i Pjeseve (Kuotat) nga 1 me vlera 58,087,300 leke.

- 4 -Te depozitohet ky Vendim ne QENDREN KOMBETARE TE REGJISTRIMIT .

Sa me siper nenshkruhet pa verejtje .

ORTAKU I VETEM

(BESNIK IBI)



RRETHI POGRADEC

**“BENAKS-94” SH.P.K E REGJISTRUAR ME NR E NIPT-IT J73804663H
ADRESA : RRUGA NCIONALE POGRADEC KORÇË KILOMETRI I PARË,
,KRAHU I DJATHTË PRANË KRYQËZIMIT PËR NË FSHATIN BUÇIMAS,
NJËSIA ADMINISTRATIVE BUÇIMAS, POGRADEC, TEL 0692098388**

**VENDIMET E ASMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR**

“BENAKS-94” SH.P.K

**PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT Nr 25/1 DATË 03.01.2019 DHE
Nr 25/2 DATË 09.01.2019**

Pogradec më 09 Janar 2019

RRETHI POGRADEC

"BENAKS-94" SH.P.K e regjistruar me Nr e NIPT-it J73804663H

Adresa : Rruga nacionale Pogradec Korçë kilometri i parë, ,Krahu i djathtë pranë kryqëzimit për në fshatin Buçimas, Njësia administrative Buçimas, Pogradec, Tel 0692098388

V E N D I M

Nr. 25/1 Date 03.01.2019

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË "BENAKS"SH.P.K.

Objekti: REALIZIMI I ANALIZËS SË AKTIVITETIT TREGTAR PËR PERIUDHËN JANAR-TETOR 2018 DHE KRYERJA E PLOTË E PROCEDURAVE TË ZMADHIMIT NË VLERË TË KAPITALIT TË SHOQËRISË.

Sot, më 03.01.2019 konform ligjeve Nr. 9723 datë: 03.05.2007 (neni 44) dhe ligjit Nr. 9901 datë: 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (neneve 81-97 e 127) si dhe mbështetur në normat e Akt-Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "BENAKS"SH.P.K, me seli: (**Rruga nacionale Pogradec Korçë kilometri i parë, ,Krahu i djathtë pranë kryqëzimit për në fshatin Buçimas, Njësia administrative Buçimas, Pogradec, Tel 0692098388**) u thirr mbledhja e "Asamblesë së Ortakëve" e përfaqësuar nga "Ortaku i vetëm Z. Besnik Ibi".

Ortaku i vetëm, Z. Besnik Ibi në cilësinë ei "Asamblesë së Ortakëve" të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "BENAKS"SH.P.K mori në analizë aktivitetin tregtar të vitit 2018. Në mbledhje u shqyrtua domosdoshmërinë për kryerjen e një analize të aktivitetit tregtar për periudhën Janar-Tetor 2018 dhe procedurat që duhet të zbatohen për Zmadhimin në vlerë të Kapitalit të kësaj shoqërie tregtare.

Ortaku i vetëm, zoti Besnik Ibi në cilësinë ei "Asamblesë së Ortakëve" të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "BENAKS"SH.P.K, pasi shqyrtoi procedurat që duhet të zbatohen për zmadhimin në vlerë të kapitalit:

REALIZOI:

Analizën dhe diskutimin e kushteve dhe të mundësive që "Audituesi ligjor, Eksperti Kontabël i Regjistruar" z.Rruezdi Shkullaku, në një afat sa më të shkurtër, deri më 15 Janar 2019 të realizojë një analizë të performancës së aktivitetit tregtar të realizuar prej shoqërisë tregtare "BENAKS"SH.P.K për periudhën Janar-Tetor 2018 dhe të kryejë procedurat për Zmadhimin në vlerë të Kapitalit.

Zoti Besnik Ibi, ortak i vetëm në cilësinë e "Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve" në shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "BENAKS"SH.P.K pasi analizoi materialet shkresore dhe dokumentet e mësipërme

VENDOSI:

Të riemërohet "Audituesi ligjor, Eksperti Kontabël i Regjistruar" në shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "BENAKS"SH.P.K deri më 31.12.2020, z.Rruezdi SHKULLAKU, i cili është regjistruar ne listën e "Audituesve ligjorë dhe të Ekspertëve Kontabël të Shqipërisë" me licencë profesionale Nr.209 datë 04.10.2010 dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë me NIPT-in: K33715746D.

"Audituesi ligjor, Eksperti Kontabël i Regjistruar" z.Rruezdi Shkullaku, në një afat sa më të shkurtër deri më 15 Janar 2019 të hartojë një raport bazuar në një analizë të performancës së aktivitetit tregtar të realizuar prej shoqërisë tregtare "BENAKS"SH.P.K për periudhën Janar-Tetor 2018.

Brenda datës 15.01.2019 të realizojë kryerjen e procedurave për Zmadhimin në vlerë të Kapitalit dhe për krijimin e Rezervave Ligjore, Statutore dhe të rezervave të tjera.

Ky Vendim të depozitohet në QKB brenda 30 ditëve nga data e nxjerrjes së tij nëpërmjet procedurës së aplikimit në QKB nga Administratori, zoti Besnik IBI. dhe të tërhiqet prej saj një një "Ekstrakt Historik i ri".

PËR SHOQËRINË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "BENAKS"SH.P.K
ORTAKU I VETËM DHE ADMINISTRATORI

BESNIK IBI




RRETHI POGRADEC

"BENAKS-94" SH.P.K e regjistruar me Nr e NIPT-it J73804663H

Adresa : Rruga nacionale Pogradec Korçë kilometri i parë, ,Krahu i djathtë pranë kryqëzimit për në fshatin Buçimas, Njësia administrative Buçimas, Pogradec, Tel 0692098388

V E N D I M

Nr. 25/2 Datë 09.01.2019

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË "BENAKS-94" SH.P.K.

Objekti: MIRATIMI I ANALIZËS SË AKTIVITETIT TREGTAR PËR PERIUHDHËN JANAR-TETOR 2018 DHE I PROCEDURAVE TË KRYERA PËR ZMADHIMIN NË VLERË TË KAPITALIT

Sot më 09.01.2019 konform ligjeve Nr. 9723 datë: 03.05.2007 (neni 44) dhe ligjit Nr. 9901 datë: 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (neneve 81-97 e 127) si dhe mbështetur në normat e Akt-Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "BENAKS-94" SH.P.K, me seli në adresën: **Rruga nacionale Pogradec Korçë kilometri i parë, ,Krahu i djathtë pranë kryqëzimit për në fshatin Buçimas, Njësia administrative Buçimas, Pogradec, Tel 0692098388**, regjistruar me Nr e NIPT-it J73804663H u thirr mbledhja e "Asamblesë së Ortakëve" e përfaqësuar nga "Ortaku i vetëm, Z. Besnik IBI".

"Asambleja e Ortakëve" e përfaqësuar nga "Ortaku i vetëm Z. Besnik IBI" në cilësinë e "Asamblesë së Ortakëve" mori në analizë aktivitetin tregtar të realizuar gjatë periudhës Janar-Tetor 2018, miratimin e Pasqyrave paraprake Financiare për këtë periudhë të vitit 2018 dhe të raportit të "Audituesit ligjor, Ekspertit Kontabël të Regjistruar" z.Rruzhdi Shkullaku, për Zmadhimin e Kapitalit në vlerë të kësaj shoqërie të hartuar në zbatim të detyrave të vendosura në Vendimin Nr.25/1 datë 03.01.2019.

Ortaku i vetëm i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "BENAKS-94" SH.P.K, zoti Besnik IBI në cilësinë e "Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve" të shoqërisë tregtare "BENAKS-94" SH.P.K, pasi analizoi projekt-propozimet dhe materialet shkresore të hartuara për zgjidhjen e problemeve të mësipërme

REALIZOI:

Diskutimin dhe miratimin e analizës së veprimtarisë ekonomike e financiare për periudhën 01.01.2018 deri më 31.10.2018, sipas objektivave të përcaktuara paraprakisht dhe sipas Pasqyrave paraprake Financiare të shoqërisë të hartuara për periudhën deri më 31.10.2018, veçanërisht për inventarin e AAM-ve (Aktiveve Afatgjata Materiale), gjendjen e mallrave, të lëndëve të para, të materialeve ndihmëse, mënyrën e evadimit sa më të shpejtë të tyre, trajtimin e punonjësve e të tjera.

Dhënie e një opinioni të arsyeshëm, prej "Audituesit ligjor, Ekspertit Kontabël të Regjistruar" për pozicionin financiar të Aktiveve, të Detyrimeve dhe të Kapitalit të Vet të shoqërisë tregtare "BENAKS-94" SH.P.K dhe për performancën e aktivitetit tregtar të realizuar gjatë vitit 2018.

Zmadhimin e Kapitalit në vlerë duke pasur si burim Fitimet Neto të realizuara të mbartura deri më 31.12.2017 dhe Fitimet Neto të deklaruara në Bilanc që përfshijnë periudhën deri më 31.12.2017.

Miratimin e vijueshmërisë së llogarive gjatë vitit 2018, rezultatin e tyre më 31.10.2018, çeljet e tyre për aktivitetin tregtar që fillon më 01.01.2018 dhe detyrat për vazhdimësinë e punës për periudhën e ardhshme të vitit 2018.

Strukturimin e Kapitaleve, shpërndarjen e Fitimeve të mbartura nga vitet e kaluara dhe krijimin e Rezervës Ligjore e Statutore konform kërkesave të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (nenet 81-97 e 127).


Diskutimin dhe analizën e strukturës së kapitalit në raportin e paraqitur prej "Audituesit ligjor, Ekspertit Kontabël të Regjistruar" z.Rruzhdi Shkullaku për ta shndërruar projekt-vendimin për Zmadhimin në vlerë të Kapitalit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "BENAKS-94" SH.P.K në Vendim.

Zoti Besnik IBI (ortak i vetëm) në cilësinë e "Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve" në shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "BENAKS-94" SH.P.K, pasi analizoi materialet shkresore dhe dokumentet e e tjera të prezantuara :

VENDOSI:

A-. Të miratohet pa vërejtje raporti për analizën e veprimtarisë ekonomike e financiare për periudhën raportuese 01.01.2018 deri më 31.10.2018, sipas objektivave të përcaktuara paraprakisht dhe sipas Pasqyrave paraprake Financiare të shoqërisë "BENAKS-94" SH.P.K të hartuara për vitin ushtrimor deri më 31.10.2018, bashkë me inventarin e AAM-ve (Aktiveve Afatgjata Materiale) dhe të materialeve të tjera në Pasqyrat Aneke.

B-. Të miratohet procedura për Zmadhimin e Kapitalit në vlerë për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "BENAKS-94" SH.P.K (ku vlerat totale të burimeve të zmadhimit janë ("Fitimet e mbartura në vite plus Fitimi i ushtrimit të realizuar gjatë vitit 2017" të cilat shprehen në vlerën 25.491.180.00 lekë).



C-. Të miratohen lëvizjet në Kapitalin e Vet të shprehura në tabelën e mëposhtme në mënyrë të përmblendhur dhe me specifika të veçanta për lëvizjet në Kapitalin e Vet bazuar në përcaktimet specifike të hollësishme të sipërcituara.

GJENDJA AKTUALE E LLOGARIVE TE KAPITALIT ME 31.12.2017, NDRYSHIMET DHE STRUKTURA E GJENDJES SE KAPITALIT QE DO TE KETE SHOQERIA TREGTARE "BENAKS-94" SH.P.K.

Numuri i llogarisë	Emertimi i llogarisë	Njesia matese	Gjendja e llogarive të kapitalit të shoqërisë më 31.12.2017	Ndryshimet e strukturës së vlerës së llogarive të kapitalit që kërkojnë të ndryshohen		Struktura e llogarive të kapitalit të shoqërisë që kërkohet për miratim më në Vendimin e datës 09.01.2019
				Shtesa	Paksime	
101	Kapitali i paguar	LEK	58,087,300.00	13,912,700.00		72,000,000.00
1071	Rezerva ligjore	LEK	1,094,291.00	6,105,709.00		7,200,000.00
1073	Rezerva statutore	LEK		3,600,000.00		3,600,000.00
1078	Rezerva të tjera	LEK		1,000,000.00	-	1,000,000.00
108	Fitimi/Humbja e pashpërndare	LEK	12,752,614.00		(11,879,843.00)	872,771.00
109	Fitimi neto I vitit ushtrimor 2016	LEK	12,738,566.00		(12,738,566.00)	-
	SHUMA		84,672,771.00	24,618,409.00	(24,618,409.00)	84,672,771.00

D-. Të miratohet pa vërejtje raporti dhe analiza e paraqitur prej "Audituesit ligjor, Ekspertit Kontabël të Regjistruar" z.Rruezdi Shkullaku, për Zmadhimin në vlerë të Kapitalit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "BENAKS-94" SH.P.K.

E-. Projekt-propozimi i paraqitur prej "Audituesit ligjor, Ekspertit Kontabël të Regjistruar" zotit Rruezdi Shkullaku për Zmadhimin në vlerë të Kapitalit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "BENAKS-94" SH.P.K të materializohet dhe të bëhet vendim duke ndryshuar strukturën e Kapitalit të Vet të deklaruar në Bilancin e aktivitetit tregtar të mbyllur për vitin 2017, e cila përfundimisht do të jetë:

GJENDJA E LLOGARIVE TE KAPITALIT DHE STRUKTURA E TIJ E CILA MIRATOHET ME "VENDIM TE ASAMBLESE TE ORTAKEVE" ME 09.01.2019

Numuri i llogarisë	Emertimi i llogarisë	Njesia matse	TE DHENAT NE LEK	
			Debi	Kredi
101	Kapital themeltar i paguar	lek	-	72,000,000.00
1071	Rezerva ligjore	lek	-	7,200,000.00
1073	Rezerva statutore	lek		3,600,000.00
1078	Rezerva të tjera	lek		1,000,000.00
108	Fitimi/Humbja e pashpërndare	lek	-	872,771.00
109	Rezultati i ushtrimit	lek	-	-
	SHUMA E KAPITALEVE TE VETA	lek	-	84,672,771.00

1.Kapitali aksioner nga 58.087.300 lekë rritet me 13,912,700.00 lekë me burim fitimet neto të mbartura dhe fitimin neto të realizuar gjatë vitit 2017 dhe përfundimisht shoqëria tregtare "BENAKS-94" SH.P.K do të ketë një Kapital të derdhur, të nënshkruar në masën 72,000,000.00 (shtatëdhjetëedymilion) lekë, i cili vlerësohet me një kuotë (e shprehur ndryshe 100%) në pronësi të zotit Besnik IBI.

2.Rezervat Ligjore do të ndryshojnë. Nga 1,094,291.00 lekë që kanë qenë, ato do të rriten me 6,105,709.00 leke dhe përfundimisht ato do të jenë në vlerën 7,200,000.00 (shtatëmilionedyqindmijë) lekë.

3.Rezervat Statutore do të ndryshojnë. Nga 0.00 lekë që kanë qenë, do të rriten me 3,600,000.00 lekë dhe përfundimisht ato do të jenë në vlerën 3,600,000.00 (tremilionegjashtëqindmijë) lekë.

4.Rezervat e tjera do të ndryshojnë. Nga 0.00 lekë që kanë qenë, do të rriten me 1.000.000.00 lek dhe përfundimisht ato do të jenë në vlerën 1.000.000.00 (njëmilion) lekë.

5.Fitimet e Pashpërndara të llogarisë 108 nga 12,752,614.00 lek që kanë qenë paksohen me (11,879,843.00) lekë dhe përfundimisht ato do të jenë të vlerësuara në masën 872,771.00 (tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) eshtatëqind e shtatëdhjetë e një) lekë.

6. Fitimi neto i realizuar gjatë vitit 2017 i cili me Vendimin Nr 24 datë 30.06.2018 në vlerën 12,738,566.00 lek ka shkuar për zgjerimin e aktivitetit tregtar paksohet me këtë vlerë dhe llogaria 109 mbetet në vlerën 0 (zero) lek.

Ky Vendim të depozitohet në QKB brenda datës 31 Janar 2019 nëpërmjet procedurës së aplikimit në QKB nga Administratori i shoqërisë tregtare "BENAKS-94" SH.P.K, zoti Besnik IBI.

PËR SHOQËRINË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "BENAKS-94 SH.P.K"

ORTAKKU I VETËM DHE ADMINISTRATORI
BESNIK IBI

BESNIK IBI
2

